

**AKT THEMELIMI  
I Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar**

**Sheqer Pikant Trattoria**

Sot, më datë 06.09.2024, personalisht:

- **Admir Metallari**, atësia Safet, shtetas shqiptar, lindur me 14.04.1983, ne Kukes, dhe banues ne Tirane, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me cilësinë e ortakut të shoqërisë tregtare.
- **Gentian Ziu**, atësia Anastas, shtetas shqiptar, lindur me 18.04.1975, ne Lushnje, dhe banues ne Tirane, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me cilësinë e ortakut të shoqërisë tregtare.

Përpilojne këte akt themelimi të shoqërisë tregtare Sheqer Pikant Trattoria sh.p.k, me termat e mëposhtme:

**NENI 1**

Të themelojnë Shoqërinë Tregtare Sheqer Pikant Trattoria SH.P.K, në formën e një Shoqërie me përgjegjësi të kufizuar. Në të gjitha aktet që do të nxjerrë shoqëria kundrejtuar të tretëve si dhe në të gjitha aktet e brendshme të saj, do të shënohet detyrimisht emri Sheqer Pikant Trattoria SH.P.K, sipas përcaktimeve të bëra në këtë Akt Themelimi dhe në Statut.

**NENI 2 Qëllimi i krijimit të Shoqërisë.**

Qëllimi i krijimit të kësaj Shoqërie është zhvillimi i aktivitetit ekonomik në fusha të ndryshme. Veprimtaria e kësaj Shoqërie do të jetë thellësisht me karakter ekonomik dhe qëllim fitimprurës.

**NENI 3 Emri dhe vula e shoqërisë**

Shoqëria, do të dalë në qarkullimin juridiko - civil me emrin e subjektit **Sheqer Pikant Trattoria** SH.P. K dhe me emrin tregtar **Trattoria Sheqer Pikant**. Ajo do të ketë edhe vulën e saj.

**NENI 4 Objekti i veprimtarisë**

Bar, Restorant, shërbim ushqimor i lëvizshëm dhe katering me porosi për raste.

**NENI 5 Selia e Shoqërisë dhe Afati**

Selia e shoqërisë ndodhet ne adresën: Rruga Fortuzi, Nr.6/410, Tirane.



Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj për një periudhe kohore pa afat.

### **NENI 6 Kapitali i Shoqërisë**

Kapitali themeltar është 100.000 (njëqind mijë) Lek dhe zotërohet nga ortaket themelues.

Vlera totale e kapitalit të regjistruar: 100.000 leke

Vlera e paguar: 100.000 leke

Numri total i kuotave: 2

Kapitali themeltar është mbuluar tërësisht nga ortaket themelues.

### **NENI 7**

Ortaket themelues të Shoqërisë Tregtare Sheqer Pikant Trattoria SH.P.K zotërojnë kuotat në këtë shoqëri si më poshtë:

- **Admir Metallari**, pjesëmarrja me përqindje 50 %, 1 kuote, lloji i kontributit në para 50.000 leke.
- **Gentian Ziu**, pjesëmarrja me përqindje 50 %, 1 kuote, lloji i kontributit në para 50.000 leke

### **NENI 8 Organet Drejtuese**

Duke ju referuar ligjit nr. 9901, datë 14/04/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë vijon:

1. Asambleja e Ortakeve – organi më i lartë vendimarrës;
2. Administratori/et – organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqërisë.

### **NENI 9 Administratori**

Shoqëria administrohet nga ana e Administratorit i cili zgjidhet për një mandat 5 (pese) vjeçar me të drejtë rizgjedhje. Administratori i parë i shoqërisë do të jenë Z. Admir Metallari, me afat 06.09.2024 deri me 06.09.2029.

Shoqëria përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga administratori, i cili i ushtron këto të drejta në përrputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.

### **NENI 10**

Ortaket mund të vendosin me vullnetin e tyre, për pjesëmarrjen në Shoqëri të tjera dhe të krijojnë çdo lloj aktiviteti tjetër privat, me përjashtim të kufizimeve të përcaktuara me ligj.

## **NENI 11**

Të punësuarit dhe të ngarkuarit me drejtimin e Shoqërisë mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen të zhdëmtojnë Shoqërinë për dëmet që i janë shkaktuar për faj të tyre.

## **NENI 12**

Mosmarrveshjet për themelimin e Shoqërisë zgjidhen me mirekuptim dhe kur kjo nuk arrihet, ato zgjidhen nga Gjykata kompetente.

## **NENI 13**

Akti i themelimit pasi u lexua nga Ortaku Themelues u gjet sipas vullnetit të tij dhe u nënshkrua pa vërejtje. Akti i Themelimi hartohet në gjuhën shqipe.

## **ORTAKET THEMELUES**

**Admir Metallari**

Admir Metallari



**Gentian Ziu**

Gentian Ziu

